

# Bizneset e Huaja në Shqipëri

## 2017

**Tiranë, më 19 Dhjetor 2018:** Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, të cilat ushtrojnë aktivitet ekonomik në vendin tonë, në vitin 2017, u rrit me 11,6 %, krahasuar me 2016. Gjatë vitit 2017, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta nga Italia dhe Greqia zënë, 54,0 % të ndërmarrjeve të huaja gjithsej, si dhe 58,7 % të të punësuarëve. Ndërmarrjet nga këto shtete, realizojnë 59,5 % të eksporteve dhe 50,8 % të importeve nga totali i import/eksporteve të ndërmarrjeve të huaja.


Ndërmarrjet me pronësi 100% të huaj mbulojnë 58,8 % të totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huaj mbulojnë 17,7 % të tyre.

Në vitin 2017, ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë 66,7 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta. Ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë 11,8 % dhe ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e tjera zënë, 21,5 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta.

### Treguesit kryesorë ekonomikë

- Në vitin 2017, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 18,7 % të të punësuarëve gjithsej në ekonominë vendase, nga 16 % që kishin punësuar në vitin 2016.
- Shitjet neto të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, në vitin 2017, përbëjnë 30,3 % të shitjeve neto gjithsej të bizneseve në vend, nga 22,7 % që ishte në vitin 2016.
- Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë realizuar 30,4 % e investimeve gjithsej, në vitin 2017 nga 46,9 % që ishte në vitin 2016.

Fig.1 Treguesit kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkëta ndaj atyre shqiptare



Në vitin 2017, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta, realizuan 49,2 % të eksporteve gjithsej nga 48,2 % në vitin 2016. Ndërsa, këto biznese gjatë vitit 2017, realizuan 28,8 % të importeve gjithsej nga 29,0 % në vitin 2016.

**Investimet e Huaja Direkte (IHD)**

Stoku i Investimet e Huaja Direkte, në vitin 2017, është rritur me 13,7 %, në krahasim me 2016. Në fund të vitit 2017, vendet e BE-së përbënin pjesën më të madhe të Stokut të IHD-ve me 56,9 %, të dominuara nga Greqia me 18,9 % dhe Holanda me 12,8 %.

**Tab.1 IHD, Stoku dhe Floë sipas vendeve (mln Euro)**

IHD	Stoku			Flow		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>4.981,7</b>	<b>5.677,3</b>	<b>6.453,5</b>	<b>890,4</b>	<b>942,5</b>	<b>899,9</b>
<b>EU-28</b>	<b>3.289,3</b>	<b>3.365,8</b>	<b>3.672,2</b>	<b>321,9</b>	<b>241,6</b>	<b>351,2</b>
Austria	386,9	359,6	447,5	23,1	23,1	55,0
Britania e Madhe	23,8	38,4	51,2	11,9	6,5	9,0
Gjermania	137,2	122,7	111,5	7,1	18,7	-20,4
Hollanda	702,8	718,0	826,3	-	-	-
Greqia	1.204,8	1.232,6	1.216,8	41,0	10,3	27,2
Italia	547,5	604,4	610,1	11,2	45,7	61,6
Të tjera EU	286,4	290,1	408,3	227,7	137,3	218,8
Zvicra	120,6	550,1	893,7	146,0	432,6	338,6
Kanada	691,4	739,5	883,8	228,0	134,8	149,1
SH B A	94,5	80,8	79,1	3,5	10,2	3,3
Të tjera	785,9	941,0	924,7	191,0	123,4	57,7

Burimi: Banka e Shqipërisë

# Metodologjia

INSTAT realizoi botimin e statistikave të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Ky botim përmban statistika nga sektorë të ndryshëm të dy institucioneve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-eve:

## **Regjistri Statistikor**

<http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrhimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABmarrjeve/>

## **Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve**

<http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrhimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/>

## **Banka e Shqipërisë**

[https://ëëë.bankofalbania.org/ëeb/Statistika\\_230\\_1.php](https://ëëë.bankofalbania.org/ëeb/Statistika_230_1.php)

## **Statistikat e Tregtisë së Jashtme**

<http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/>

## **Përkufizimet kryesore**

**Ndërmarrja** është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

**Shitjet neto** përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

**Numri i të punësuarve** përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

**Investimet** gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.